

VENDIM
Nr. 183, datë 10.9.2021

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “ENERGY PLUS” SHPK, PËR
TRANSFERIMIN E ASETVEVE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, pika “a”, nenit 44, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”; pikat 1.3 dhe 1.6, të “Licencës për prodhimin e energjisë elektrike”, si dhe nenit 8, të “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve nga të licencuarit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 119, datë 21.7.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 10.9.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 118/2 prot., datë 3.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k., për transferimin e aseteve”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 839 prot., datë 21.7.2021, ka paraqitur kërkesën për transferimin e aseteve.

- Shoqëria “Energy Plus” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 112, seria PV10K, në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike dhe licencës nr. 113, seria T10P, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Kërkesa e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. nuk është shoqëruar me asnjë dokumentacion, sipas legjislacionit në fuqi, çka bën të pamundur marrjen e saj në shqyrtim nga ERE.

- Për nevoja të aplikimit për transferim asetesh, nga ana e shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. bashkëlidhur kërkesës duhet të përcillet edhe i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga neni 7, i “Rregullores së procedurave të transferimit të aseteve të të licencuarve”, si dhe vlera e aseteve fikse që kërkon të transferojë, duke qenë se ERE, në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, shprehet vetëm për asetet fikse të të licencuarit, të përdorura për kryerjen e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mos fillojë procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Energy Plus” sh.p.k. për transferim të aseteve.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE, brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti